Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

14 -12- 2024

Prishtinë / Priština
Nr./Br. 01-2188 - 2024

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE** , në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal Nr.01/2017, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 14.12.2024, nxjerr këtë:

## VENDIM

## Për Emërimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal

I. **Znj.Fjolla Dembogaj,** emërohet anëtare e kuvendit komunal në Pejë, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtaren e kuvendit komunal znj.Xhevahire Çeku Kelmendi.

II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Fjolla Dembogaj dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 12.12.2024, Nr.07/7-2179/2024, për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal znj.Xhevahire Çeku Kelmendi, e cila ka dhënë dorëheqje për arsye të punësimit.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirenditur është znj.Fjolla Dembogaj.

Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 14.12.2024

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centarlna Izborna Komisija
Central Election Commission

14 -12- 2024

Prishtinë / Priština
Nr./Br. 01 - 2188 - 2024

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA,** u skladu sa ovlašćenjima datim članom 10. Zakona br.03/L-072 o lokalnim izborima u Republici Kosovo, članom 37. stav 2. podstav (c) Zakona br.03/L- 040 o lokalnoj samoupravi, članom 3, članom 5 stav 5.1.3, članom 6 i članom 7 Administrativnog uputstva br.01/2017 za zamenu odbornika Skupštine opštine, na redovno održanom sastanku 14.12.2024, donosi:

# ODLUKA

## O imenovanju člana Skupštine opštine

I. **Gđa. Fjolla Dembogaj,** imenuje se za odbornika Skupštine opštine Peć, iz političkog subjekta "Partia Demokratike e Kosovës", zamenjujući odbornika Skupštine opštine gđu. Xhevahire Çeku Kelmendi.

II. Obavezuje se Sekretarijat CIK-a da ovu odluku saopšti gđi. Fjolla Dembogaj i da preuzme proceduralne radnje za sprovođenje.

III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

**Obrazloženje**

Centralna izborna komisija je razmotrila dokumentaciju predmeta dostavljenu CIK-u dana 12.12.2024, br.07/7/2179/2024, za zamenu odbornika Skupštine opštine gđe. Xhevahire Çeku Kelmendi, koja je podnela ostavku zbog zapošljavanja.

Uvidom u zahtev i priložene dopise, verifikovano je i utvrđeno da je nardeni kandidat na preuređenom spisku gđa.Fjolla Dembogaj.

Naredni kandidat je dao izjavu o prihvatanju mandata, iz istog političkog subjekta, sa najvećim brojem glasova, koji ne prelazi kvotu rodne zastupljenosti manjinskog roda, prema potvrđenim rezultatima lokalnih izbora 2021.

Stoga je CIK nakon ispunjenja svih zakonskih uslova odlučio kao u tački I ove odluke.

Priština, 14.12rb..2024

Kreshnik RADONIQI

Predsedavajući CIK-a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centarlna Izborna Komisija
Central Election Commission
14-12-2024
Prishtinë / Priština
Nr./Br. 01 - 2189 - 2024

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,** në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 23 të Rregullores së Brendshme Nr. 02/2024, Për Pranimin e Personelit të Përkohshëm në KQZ, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 14.12.2024, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**Për Miratimin e Grupit të Pestë të Pozitave sipas Departamenteve, për Angazhimin e Stafit jo Permanent**

I. Miratohen grupi i pestë i pozitave sipas departamenteve, për angazhimin e stafit jo permanent, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025.

II. Lista me pozita si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 14.12.2024

**Kreshnik RADONIQI**

Kryesues i KQZ

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centarlna Izborna Komisija
Central Election Commission
14 -12- 2024
Prishtinë / Priština
Nr./Br. 01 - 2190 - 2024

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE,** në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 si dhe nenit 113 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, , në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 14.12.2024, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**Për Miratimin e Kërkesës për Furnizim me Inventar, Kontratë me AQP-në - LOT 2 dhe Lot 3**

I. Miratohet Kërkesa për furnizim me inventar karrige, orman dhe tavolina pune, Kontratë me AQP-në - LOT 2 dhe Lot 3.

II. Kërkesa si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 14.12.2024

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ